



NE JEMI ATA QË FLASIN PËR FENË E ZOTIT

Profeti i Islamit, Muhamedi (a.s)

Shënim: Kur përmendim figura të larta, si Profetët apo Imamët (12 pasardhësit e Profetit Muhamed, që janë Imamë Shi'ia) apo gra të shenjta, si shenjtorja Mari apo Fatimja, vajza e Profetit, pas emrit të tyre vendoset shkurtesa “a.s”, e cila rrjedh nga gjuha arabe e që në shqip ka kuptimin “paqja qoftë mbi të”. Ndërsa, kur përmendim Profetin Muhamed, pas emrit të tij vendoset shkurtesa “s.a.v.s”, që në shqip d.m th. “paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të dhe mbi pasardhësit e tij”.

Përfaqësuesit e komunitetit në Albany

سرشناسه:	قدیری ابیانہ، محمدحسن، ۱۳۳۲ -
عنوان قراردادی:	Ghadiri Abianeh, Mohammed Hassan
عنوان و نام پدیدآور:	This is Islam. Albanian
مشخصات نشر:	Ky eshte Islami/ Nga Mohammed Hassan Ghadiri Abianeh; përktheu nga anglishtja Edlira Osmani. Qum: Al-Mustafa International Translation and Publication Center, 2014= 1393.
شابک:	۹۷۸-۹۶۴-۱۹۵-۹۰۸-۳
فروست اصلی:	مرکز بین المللی ترجمه و نشر المصطفی ۷۹/پ/۱۵۲/۱۳۹۳
فروست فرعی:	نمایندگی آلبانی ۱۴
وضعیت فهرست نویسی:	فیفا
یادداشت:	آلبانیایی.
آوانویسی عنوان:	دیس از اسلام
موضوع:	اسلام
موضوع:	اسلام -- عقاید
موضوع:	اسلام -- مطالب گونه گون
شناسه افزوده:	عثمانی، ادلیرا، ۱۹۸۷ - م. مترجم
شناسه افزوده:	Osmani, Edlira
رده بندی کنگره:	BP۱۱/ق۴د۹۰۴۹۵۱۲ ۱۳۹۳
رده بندی دیویی:	۲۹۷/۰۴
شماره کتابشناسی ملی:	۳۶۰۰۳۵۴

KY ËSHTË ISLAMI

Mohammed Hassan Ghadiri Abianeh

Shqipërimi & parathënia:
Edlira Osmani



Centre International
de Traduction et de Publication Islamique
Al-Mustafâ - Qom

Titulli: KY ËSHTË ISLAMI

Autori: Mohammed Hassan Ghadiri Abianeh

Përktheu Nga Anglishtja: Edlira Osmani

Redaktoi: Klodiana SMAJLAJ

Korrektura Teknike: Jetmir ÇELA

Botoi: Al-Mustafa International Publication And Translation Center

Tiranë: 2014

ISBN: 978-964-195-908-3

این است اسلام

مترجم: ادلیرا عثمانی
ناشر: مرکز بین المللی ترجمه و نشر المصطفی ﷺ
قیمت: ۱۰۵۰۰۰
تیراژ: ۳۰۰

مؤلف: محمد حسن قدیری ابیانہ
چاپ اول: ۱۳۹۳ ش / ۲۰۱۴ م
چاپ: نارنجستان

© Centre International de Traduction et de Publication «Al Mustafâ»

- IRAN, Qom: Bld Moallém Ouest (Hodjatiyyeh) – Tél : 025-37839305-9
- IRAN, Qom: Bld Mohammad Amine, Bifurcation Sâlâriyyeh – Tél : 025-32133106 – Fax : 025-32133146
- IRAN, Téhéran: Av. Ênghélâb, croisement des Avenues Chirâzi et Qods, 1003, Rue Osku – Tél : 021-66978920
- IRAN, Mashad: Av. Êmâm Rézâ, Ave. Dânéche Est, entre Dânéshe 15 et 17 – Tél: 0511-8543059

pub.miu.ac.ir miup@pub.miu.ac.ir

WE WISH TO ACKNOWLEDGE THE ASSISTANCE OF ALL FOR FINALIZATION OF THIS BOOK

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje.....9

Mirënjohje.....15

Kreu I: Njohuri të përgjithshme

Islami nëpër botë.....19

Kuptimi i fjalëve “Islam” dhe “musliman”19

Besimi islam bazohet në logjikë.....21

Bazat e besimit islam.....23

Shtyllat e Islamit.....23

Zoti në Islam.....24

Vetëdija mbi Zotin dhe adhurimi ndaj Tij.....26

Lidhja e njeriut me Zotin.....28

Dita e Gjykimit.....29

Mëkati fillestar.....29

Rrëfimi i mëkatit.....31

Kreu II: Profetët

Profetët dhe drejtësia hyjnore.....37

Islami i vërteton shpalljet e zbritura para Kur’anit.....39

Ademi dhe Havaja sipas Kur’anit.....40

Profetët në Islam.....42

Detyrat e njerëzimit ndaj profetëve.....42

Ibrahimi, profet i Islamit.....45

Musai, profet i Islamit.....46

Kreu III: Maria dhe Jezusi (a.s.) në Islam

Maria dhe Jezusi (a.s.) në Islam.....	51
Virgjëresha Mari në Islam.....	51
Lindja e Jezusit (a.s.).....	52
Jezusi (a.s.) u foli njerëzve që në djep.....	53
Jezusi (a.s.), Profet i Islamit.....	55
Në ungjillet e krishtera, Jezusi (a.s.) e quan veten Profet..	57
Triniteti në kontekstin historik.....	60
Respekti i Jezusit (a.s.) për Marien.....	62
Përvulësia e Jezusit (a.s.).....	63
Mrekullitë e Jezusit (a.s.).....	63
Rreth kryqëzimit të Jezusit (a.s.).....	65
Hebrenjtë, të krishterët dhe muslimanët.....	67
Të krishterët në Kur'an.....	69
Ngjitja e Jezusit (a.s.) në Parajsë.....	70
Profetët pas Jezusit (a.s.).....	71

Kreu IV: Profeti Muhamed

Profeti Muhamed.....	75
Thënie të Profetit Muhamed (s.a.v.s.).....	79
Thënie të Imam Aliut.....	84
Çfarë është Kur'ani?.....	87
Mesazhi i vërtetë i Kur'anit.....	88
Kur'ani dhe shkenca moderne.....	90
Një shenjë për njerëzimin: fati i Faraonit.....	91
Falja në Islam.....	92
Rreth trinitetit në Kur'an.....	95
Kuptimi i ritualit të faljes.....	97
Qabeja, "Shtëpia e Zotit"	99
Pelegrinazhi në Mekë.....	99
Shi'izmi është sinonim i Islamit.....	101
Dymbëdhjetë Imamët.....	102

Kreu V: Gratë në Islam

Gratë në Islam.....	109
Drejtësia dhe të drejtat e grave.....	110
Veshja në Islam.....	112
Diskriminimi i grave.....	113
Seksi në Islam.....	115
Martesa në Islam.....	116
Poligamia.....	119
Martesa e përkohshme.....	123
E drejta për divorc.....	124
Gratë në Iran.....	127
Rreth homoseksualitetit dhe incestit.....	127

Kreu VI: Çështje të veçanta

Detyrat e muslimanëve ndaj njëri-tjetrit.....	131
Rreth prindërve.....	132
Higjiena në Islam.....	133
Ndëshkimi në Islam.....	134
Dënimi me vdekje.....	136
Ndalimi i ngrënies së mishit të dërrit.....	137
Ndalimi i alkoolit.....	139
Të drejtat e kafshëve.....	140

Kreu VII: Shtojca

Shtojca 1:

Çfarë është Kur'ani?.....	145
---------------------------	-----

Shtojca 2:

Krahasimi ndërmjet Islamit, Katolicizmit dhe Judaizmit...159
Koncepti i Zotit.....159
Lutja.....160
Besimi.....161
Jezusi dhe Maria.....163
Mëkati fillestar.....165

Martesa.....	167
Gratë.....	168
Hyrja në besim.....	170
Detyrat ndaj profetëve.....	171
Shtojca 3:	
Dija në Islam.....	173
Kur'ani dhe dija.....	173
Çfarë ka thënë Profeti Muhamed për dijen?.....	174
Thënie të Imam Aliut.....	181
Thënie të imamit shiit Jald.....	182
Shtojca 4:	
Thënie nga njerëz të famshëm.....	183
Faqe interneti.....	205

HYRJE

Me emrin e Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

﴿*Natyrisht, edhe kjo është shenjë e vërtetë për ata që mendojnë.*﴾

(Kur'an, 16:67)

Në vitin 1971, unë kam qenë tetëmbëdhjetë vjeç. Sapo kisha marrë diplomën e shkollës së mesme në Teheran dhe po përgatitesha të shkoja në Firence të Italisë, për të studiuar për Arkitekturë. Ky ishte fillimi i njohjeve të mia me mendimin perëndimor.

Një ditë, një shok klase (italian), më pyeti se cilit besim i përkisja. Me sinqeritet të plotë, iu përgjigja: "Jam musliman". Ai më pa me dyshim dhe tha: "Po pse je musliman?"

"Jam i tillë sepse në vendin dhe në familjen time, që të gjithë ndjekin fenë islame", - ia ktheva sërish me çiltërsi.

Pasi ia thashë këtë, u mendova gjatë rreth fjalëve të mia. A ishin të logjikshme ato? Në fund të fundit, nëse feja, besimi apo këndvështrimi ynë për Zotin është i paracaktuar nga familjet tona apo nëse ai bazohet në traditën e shumicës së njerëzve të një vendi, atëherë edhe hebreu, i krishteri apo budisti, i ndjek këto mësimet të paracaktuara dhe mund të besojë gjithashtu, se lopa është e shenjtë apo se sekretet e universitetit gjenden brenda një idhulli prej balte apo guri.

Lind pyetja: "Kush apo çfarë është Zoti?" Nëse "nuk ka Zot tjetër përveç Tij", a e bën kjo Atë një qenie të vetme?



Apo, a ndodhet Zoti brenda trinitetit, ose a janë të ngjashëm “Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë” me treshen Brahma-Vishnu-Shiva? Apo, a është Zoti i mishëruar në një statujë, në zjarr apo në kultin e diellit? A janë këta elementë të mbartur dhe të trashëguar në familje?

Në njëfarë mënyre, këto lloj gjërash nuk më bindnin. Thjesht nuk kishin logjikë. Në atë moment, vendosa të kërkoj përgjigje për pyetjet e mia; fillova të lexoj dhe të studioj, për të gjetur të vërtetën, sigurisht nëse një e vërtetë e tillë ekzistonte. Në atë fazë, nëse kërkimi im do të më provonte se Islami kishte gjëra të gabuara, atëherë isha tërësisht i përgatitur ta braktisja atë. Do të pranoja një tjetër fe, nëse do t’i gjeja të vërteta mësimet e saj. Madje, mund të hiqja dorë edhe nga të gjitha fetë së bashku e t’ia ktheja shpinën Zotit, të bëhesha ateist dhe të pohoja se Zoti nuk ekzistonte.

Në fillim mendova se vendimi për ta gjurmuar Zotin në besimet e tjera, mund të konsiderohej si “mëkat” nga standardet islame, derisa zbulova se Kur’ani i përforconte veprimet e mia:

﴿Kur atyre u thuhet: “Ndiqni atë që ka shpallur Allahu!”, ata përgjigjen: “Jo! Ne do të ndjekim atë udhë, në të cilën i kemi gjetur të parët tanë” - Vallë, edhe atëherë kur të parët e tyre nuk kuptonin gjë e nuk ishin të udhëzuar?!﴾

(Kur’an, 2:170)

﴿...Le të gëzohen ata që shmangen nga adhurimi i idhujve e kthehen nga Allahu! Pra, jepu lajme të gëzueshme robërve të Mi, të cilët, pasi i dëgjojnë fjalët (që u thuhet), ndjekin atë që është më e mira prej tyre. Këta janë ata që Allahu i ka udhëzuar në rrugë të drejtë; këta janë mendarët.﴾

(Kur’an, 39:17-18)

Kështu, detyra e parë ishte gjetja e përcaktimit të Zotit. A ekziston Zoti? A shfaqet Ai, ashtu siç mund të shfaqet edhe në fetë e tjera? A është Ai një individ, një pamje, një



bindje mistike? Apo, ndoshta gjendet përtej mësimeve të feve të tjera? Gjithsesi, si do të mund ta gjeja Atë?

Të studioje në Itali, me Vatikanin në qendër të saj, ishte një mundësi e mirë për t'u njohur me Kishën Katolike. Sidoqoftë, Firencja ishte plot me studentë iranianë, të cilët ishin në kërkim të një game të gjerë të vërtetash politike. Ata varionin nga e majta në të djathtë, ku përfshiheshin maoistë pro-kinezë, komunistë pro-sovjetikë, liberalë, konservatorë si dhe ekspertë të një spektri të gjerë të larmisë politike italiane. Kështu, unë pata mundësinë të shqyrtoja standarde të ndryshme.

Vazhdova kështu për dy vjet me radhë, por në fund të fundit duhej të isha i ndershëm me veten. Pasi eksploroja çdo alternativë të mundshme, pasi intervistova çdo njeri që takova, pasi ndoqa çdo gjurmë, duke përfshirë këtu çdo bindje fetare, filozofike dhe politike, arrita në përfundimin se Islami është pasqyrimi i vërtetë dhe hyjnor i Zotit dhe se unë e pranoj atë, jo për shkak të traditës, por për shkak të bindjes time.

﴿Ja, kështu jua shpjegon Allahu shpalljet e Tij, që të mund të mendoni.﴾

(Kur'an, 2:219)

Megjithatë, kam biseduar me shumë njerëz mbi çështje të ndryshme, lidhur me eksplorime intelektuale të çdo lloji. Dhe, duke qenë se nuk kisha mundësi të studioja teologji apo të ndiqja shkollën e Kur'anit, i përmblodha mendimet në këtë libër, me qëllim që të ndaja me të tjerët, studimet, mendimet dhe përvojat e mia, të bazuara në tridhjetë e shtatë vjet kërkime. Kështu, këtë vepër ua kushtoj të gjithë atyre që, sikurse edhe unë, besojnë se thelbi i Zotit gjendet diku përtej traditave familjare apo përtej institucionit mbizotërues fetar në vendin e tij të origjinës.

Këtë libër ia kushtoj, gjithashtu, edhe atij lexuesi që është i përgatitur të përdorë logjikën dhe jo dogmën në



mendimet e veta, lexuesit që është në gjendje të çlirohet nga nocionet e parathëna të Islamit, atij lexuesi që është i gatshëm të hapë mendjen ndaj besimeve të ndryshme nga ai i veti.

I bëj thirrje lexuesit, që është i aftë të mendojë përtej paragjykitimit anti-islam të Perëndimit. Ia drejtoj këtë vepër lexuesit objektiv, mendimet e të cilit nuk janë të ndikuara nga media, atij që nuk paragjykon që nga fillimi, duke u bazuar në fjalë të gabuara, sipas të cilave Islami është një fe e prapambetur, e dhunshme dhe shtypëse, me një mospërfillje të brendshme për të drejtat e njeriut, e veçanërisht, për të drejtat e grave.

Kjo propagandë antiislame është bërë veçanërisht e ashpër në këto vitet e fundit, me një qëllim të qartë: për të dëmtuar imazhin e njërës prej tri feve më të mëdha monoteiste, për ta dekurajuar publikun nga leximet e mëtejshme për Islamin si dhe nga të kuptuarit e botës muslimane.

Prandaj, libri im synon të hapë mendjen e lexuesit, të paraqesë analiza dhe informacione, duke zbuluar natyrën thelbësore të moralit të lartë dhe vlerave shpirtërore të një feje, që ka një miliard e gjysmë ndjekës në mbarë botën.

Islami është një forcë lëvizëse, e gjallë, e bazuar në logjikë dhe mirëkuptim. Gjithashtu, kjo fe është shfaqje e drejtësisë dhe e arsyes, me një ideologji të thellë dhe të dukshme, që synon t'i japë madhësi konceptit të Zotit dhe të profetëve, duke përfshirë këtu Jezusin dhe Marien, të cilët zënë një vend të rëndësishëm në histori. Një kapitull apo *sure*, siç quhet në Kur'an, mban emrin e Maries. Një tjetër kapitull, "El-Maide" (*Tryeza*) e përshkruan ushqimin e shërbyer në Darkën e Fundit, si të ardhur nga Parajsja.

Islami është një sistem integral, si i mendimit mistik, ashtu edhe i atij pragmatik, që jep zgjidhje reale për jetën e individit dhe të komunitetit të tij. Duke marrë më shumë dije rreth rregullave islame, lexuesi është më i përgatitur për të hyrë në realitetin e botës muslimane.



Duke pasur parasysh se pesëdhjetë e shtatë vende në mbarë botën kanë shumicë muslimane dhe se edhe në vende të tjera, kryesisht në Perëndim, ekzistojnë komunitete të mëdha muslimane, ky libër shërben si një mjet i paçmuar për studentët, diplomatët apo biznesmenët, të cilët kanë pasur të bëjnë me larmishmëri morale, fetare dhe gjeografike.

Prandaj, unë sugjeroj që këtij libri t'i bëhet një qasje akademike, në këndvështrimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe gjeopolitike, tregut ndërkombëtar, ligjit ndërkombëtar, të drejtave të njeriut, historisë së botës, filozofisë, komunikimit dhe kulturës, historisë së artit, administrimit strategjik, teologjisë, sociologjisë, antropologjisë, marrëdhënieve me publikun, gazetarisë, turizmit, letërsisë, shkencave politike, kinematografisë e dokumentarëve, diplomacisë e gastronomisë.

Kushdo që e lexon këtë libër, do të gjejë çelësin drejt të kuptuarit më të mirë të botës islame dhe drejt përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet kulturave, feve dhe qytetërimeve, veçanërisht me Iranin.

Do të jetë kënaqësi e madhe për mua, nëse do të m'i përcillni nëpërmjet postës elektronike, përshtypjet tuaja rreth këtij libri.

Mohammed Hassan Ghadiri Abianeh

Mh.ghadiri@gmail.com

Gusht, 2010

Mohammed Hassan Ghadiri Abianeh

